



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:169803
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05569909

C.nr.297/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësit D...I... nga Skenderaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Fisnik Sogojeva nga Prishtina, kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Lokale “E....K....” SH.A, me adresë në rr.” N..”, Skenderaj, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Enver Qerkini, me objekt kontesti: Anulim vendimi, kthim në vendin e punës dhe kompensim dëmi, pas mbajtje se shqyrtimit kryesor, me datën 12.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit D...I... nga Skenderaj, me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i datës 18.07.2023 me nr. të protokollit 50/2023 të datës 24.07.2027 i Bordit të NPL “E....K....” SH.A, përmes të cilit paditësi është liruar nga detyra, të detyrohet e paditura që paditësin, ta kthejë në vendin e punës në pozitën Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar, sipas kontratës së punës dhe të detyrohet e paditura t’ia kompensoj paditësit në emër të dyfishit të të ardhurave personale, shumën prej 8,743.00€ në emër të pagave bruto, në të cilën përfshihen paga neto në shumën prej 7,673.81€, kontributi pensional në trustin pensional në emër të pënëmarrësit në shumën prej 437.16€, kontributi pensional në trustin pensional në emër të punëdhënësit në shumën prej 437.16€, tatimi në pagë në dobi të buxhetit të Kosovës në shumën prej 632.25€, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e parashtimit të padisë e deri në përfundimin e ekzekutimit të aktgjyqimit, **si e pabazuar.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi me datën 08.08.2023, pranë kësaj gjykata ka paraqitur padi të cilën e ka precizuar në seancës e datës 05.04.2024, kundër të paditurës Ndërmarrja Publike Lokale “E....K....” me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm vendimi i datës 18.07.2023 me nr. të protokollit 50/2023 të datës 24.07.2027 i Bordit të NPL “E....K....” SH.A, përmes të cilin paditësi është liruar nga detyra, të detyrohet e paditura që paditësin, ta kthejë në vendin e punës në pozitën Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar, sipas kontratës së punës, dhe të detyrohet e paditura t’ia kompensoj paditësit në emër të dyfishit të të ardhurave personale, shumën prej 8,743.00€ në emër të pagave bruto, në të cilën përfshihen paga neto në shumën prej 7,673.81€, kontributi pensional në trustin pensional në emër të pënëmarrësit shumën prej 437.16€, kontributi pensional në trustin pensional në emër të punëdhënësit shumën prej 437.16€, tatimi në pagë në dobi të

buxhetit të Kosovës në shumën prej 632.25€, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e parashtrimit të padisë e deri në përfundimin e ekzekutimit të aktgjykimit.

I autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklaroj se nga provat e administruara dhe të laboruara në gjykatë arrijmë në prova të pakontestueshme se padia dhe kërkesëpafia duhet të aprovohet ashtu që vendimi kontestues të shpallet i pavlefshëm pa asnjë bazë ligjore i'u ka ndërprerë kontrata e punës palës paditëse, ashtu që kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës është bërë duke i'u referuar ligjit të punës ashtu që vendimi kontestues është në kundërshtim të plotë me nenin 70, 71 dhe 85 të Ligjit të Punës. Vendimi kontestues sa i përket arsytetimeve tjera të pabaza dhe të pambështetura se paditësi nuk ka dorzuar raporte të punës në bazë të provave është vërtetuar se është i paqëndrueshëm sepse paditësi në bazë të raporteve të rregullta mujore dhe vjetore para bordit për punën e tij të njëjtat raporte i janë aprovuar në mënyrë unanime nga i njëjti bord me çka vërtetohet se puna e tij si sekretar ka qenë në nivelin më të mirë të punës. Ndërsa arsyetimet tjera se kinse ka qenë i sëmurë, nuk ka komunikuar me kryeshefën dhe e ka mbyllë librin e protokollit janë tërësisht të pabazuara dhe argumentet e palës paditëse vërtetohen me provat tjera. Për pjesën tjetër të fjalës përfundimtare mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadiisë dhe precizimit ashtu që të detyrohet e paditura ta kthejë në vendin e punës në pozitën sipas kontratës së punës. Gjithashtu shpenzimet e procedurës i kërkojmë dhe atë 104 euro për padi, për 3 seanca nga 134 euro për seance, 20 euro për taksë gjyqesore dhe për ekspertizë 250 euro.

Paditësi në seancën kryesore deklaroj se përveç bazës ligjore të Ligjit të Punës dhe kontratës së punës për punën e Ndërmarrjeve Publike të saj duhet të bëhet auditim i ndërmarrjes ndërsa vendimi i të paditurës është marrë ad hoc, pa paralajmërim dhe pa vërejtje dhe pa një raport të auditorit sepse i vetmi unë si zyrtar i lartë jamë i certifikuar për punën në bord, menaxhimin e korporatave dhe për punën e sekretarit nga asoacioni i ndërmarrjeve publike si dhe në bashkëpunim me G..... Gj.... dhe shkarkimi im dhe lirimi nga detyra ka ardhë në një moment të paparalajmëruar ku mua më ka shkaktuar përveç shqetësimit dhe jamë ndjerë i fyer nga ish kolegët dhe anëtarët e bordit për arsye se asnjëherë nuk kanë pas vërejtje për punën dhe angazhimin tim në ndërmarrje. Përveç dëmeve ekonomike materiale me kanë shkaktuar edhe dëme emocionale për arsye se në atë kohë kam qenë në pritje për tu bërë prind dhe mirëqenja ime është varur nga babai im i cili është invalid i luftës si dhe nga nëna e cila është e punësuar. Dhe për provat të cilat i ka paraqitur e paditura edhe pse arsyetimi ka qenë i paraqitur në disa vende ka qenë i përsëritur ne kemi paraqitur nga një provë materiale për secilin aludim të të paditurës për të mos e ngarkuar lëndën me prova.

I autorizuari i të paditurës në fjalën përfundimtare deklaroj se qëndrojmë pranë përgjigjes në padi pranë çdo deklarimi të dhënë në seancat e kaluara po ashtu pranë deklarimit të dhënë si më lartë. Vendimi i marrur nga Bordi i Drejtorëve është vendim i drejtë dhe konform ligjit dhe çdo pretendim i jonë i specifikuar në përgjigje në padi, pa dashur t'i ripërsërisim të njëjtat, po ashtu argumentimi i dhënë në seancën e kaluar nga dëshmitarët kryeshefë i ndërmarrjes dhe kryesuesi i ndërmarrjes, gjitha ato dëshmi janë dëshmi kryesore të cilat argumentojnë dhe pasqyrojnë në mënyrë të detajuar tërë rrjedhën e këtij procesi dhe e legjitimojnë për vendimin e marrur nga bordi i drejtorëve për lirim nga detyra ish sekretarin tani paditësin D...I..., po ashtu mbështetja ligjore për një vendim të tillë nga ana e bordit të drejtorëve ekziston në nenin 21 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmarrje Publike nr.03/L-87, kjo dispozitë ligjore mbizotëron mbi çdo dispozitë ligjore kontraktuese, prandaj kjo dispozitë ligjore është zbatuar në përpikni për arsye se vetë ligji është ligj special i cili rregullon fushën e ndërmarrjeve publike dhe në çdo kohë dhe mënyrë u ipet e drejta ligjore Ndërmarrjeve Publike përkatësisht Bordit të Drejtorëve se në çdo kohë kur ata e shohin të arsyshme për zbatimin e kësaj dispozite ligjore vetë ligji u'a mundëson e që edhe

në rastin konkret kanë vepruar dhe e kanë zbatuar të njëjtin e po ashtu duke i zbatuar dhe implementuar dispozitat ligjore pa dashur t'i specifikoj një nga një e të cilat janë specifikuar në dispozitivin e vendimit me të cilin vendim është liruar nga detyra ish sekretari tani paditësi D...I.... Prandaj kësaj gjykate i propozojmë në bazë të gjitha të lartëcekurave që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ekspertiza financiare e dt. 24.11.2023 si dhe plotësimi i saj i dt. 11.03.2024, kontrata e punës me numër 22/021 e datës 02.08.2021, vendimi nr.22/021 i datës 02.08.2021, vendimi nr.50/23 i datës 24.07.2023, raporti vjetor i punës për vitin 2022 i datës 28.02.2023, rendi i ditës për mbledhjen e datës 28.02.2023, raporti i punës për tremujorin Janar – Shkurt- Mars i datës 27.04.2023, emaili i datës 12.06.2023 së bashku me dy raporte mjekësore, emailat e datës 23.05.2023, 30.05.2023, 05.06.2023, miratimi i planit të biznesit të vitit 2023 i datës 01.11.2022 dhe dëgjimi i dëshmitarëve A.... I.... dhe Sh.... M....

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar**.

3. Faktet

Me leximin e kontratës së punës me numër 22/021 e datës 02.08.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka lidhur kontratë të punës me të paditurën NPL “E....K....” SH.A, për pozitën Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar, me kohë të caktuar duke filluar nga data 02.08.2021 deri me datën 01.08.2026.

Me leximin e vendimit nr.22/021 i datës 02.08.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D...I.... me datën 02.08.2021, është emëruar Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i NPL “E....K....” SH.A në Skenderaj.

Me leximin e vendimit nr.50/23 i datës 24.07.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi D...I.... me datën 24.07.2023, është liruar nga detyra si Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i NPL “E....K....” SH.A në Skenderaj.

Me leximin e raportit vjetor të punës për vitin 2022 i datës 28.02.2023 dhe leximin e rendit të ditës për mbledhjen e datës 28.02.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pranë Bordit të Drejtorëve të NPL “E....K....” SH.A në Skenderaj, ka paraqitur raportin e punës për vitin 2022 dhe ky raport është miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve të kësaj ndërmarrje.

Me leximin e raportit të punës për tremujorin Janar – Shkurt- Mars i datës 27.04.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka përgatitur raportin për tremujorin e parë të vitit 2023.

Me leximin e emailit të datës 12.06.2023 së bashku me dy raporte mjekësore, gjykata vërtetoi faktin se paditësi me datën 26.06.2023, përmes këtij emaili i ka njoftuar anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefin Ekzekutiv të NPL “E....K....” SH.A, se është në pushim mjekësor.

Me leximin e emailave të datës 23.05.2023, 30.05.2023, 05.06.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi dhe Kryeshefi Ekzekutiv i NPL “E....K....” SH.A, kanë pasur komunikime rreth formimit të një komisioni e cila nuk është fare relevante në vendosjen e kësaj çështje kontestimore.

Me leximin e miratimit të planit të biznesit të vitit 2023 i datës 01.11.2022, gjykata nuk vërtetoi asnjë fakt relevant që lidhet me vendosjen e kësaj çështje kontestimore.

Me leximin ekspertizës financiare e dt. 24.11.2023 si dhe plotësimi i saj i dt. 11.03.2024, gjykata vërtetoi faktin se lartësia e paga të cilat do t'i merrte paditësi si Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i NPL "S.... i A...." është në lartësi prej 8,743.00€ bruto, ku përfshihen paga neto në lartësi prej 7,673.81€, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të të punësuarit në shumën prej 437.16€, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit në shumën prej 437.16€, tatimi në paga që duhet paguar në dobi të Buxhetit të Kosovës në shumën prej 632.25€, ndërsa kamata ligjore për këtë detyrim është në shumën prej 175.38€.

Dëshmitari A.... I.... ndër të tjera deklaroj se unë jam kryesues i Bordit të NPL "E....K...." SH.A, aktualisht dhe kam qenë kryesues edhe në kohën kur është marrë vendimi mbi lirimin e tij nga detyra. Unë mendoj se vendimi të cilin e kemi marrë ka qenë i bazuar në ligjet të cilat janë për ndërmarrjet publike, ka qenë vendim i drejtë në bazë të fakteve që na janë ofruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili ka bërë propozimin. I njëjti deklaroj se si pikë më të rëndësishme për lirimin e paditësit nga detyra janë mos bashkëpunimi me Kryeshefin Ekzekutiv nga ana e sekretarit dhe mos nxjerrja e vendimeve për aprovimet e Bordit gjatë mbledhjeve. Gjatë mbledhjeve të Bordit ka pasur miratime qoftë të rregulloreve të punës dhe vendime tjera në lidhje me ndërmarrjen për të cilat nuk janë nxjerr vendime nga ana e sekretarit dhe ka deklaruar që vetëm me procesverbal merret vendimi të cilin ne e kemi kundërshtuar. I njëjti deklaroj se paditësi raportet i ka dorëzuar gjithmonë me kohë dhe janë të aprovuara nga Bordi dhe se nuk ka pasur vërejtje me shkrim, por vetëm diskutime lidhur me përmirësimin e procesit të punës.

Dëshmitari Sh.... M.... deklaroj se unë konsideroj se është e rëndësishme të tregoj krejt ecurinë e rrjedhës se si ka ardhur deri tek ky vendim, pasi në vendim janë cekur edhe disa arsye për lirim nga detyra e sekretarit – këshillëtarit të ndërmarrjes ku janë dhënë shumë argumente dhe arsye në pjesën e vendimit pjesën e dytë të arsyetimit të vendimit mbi lirim nga detyra. Ku shumica e atyre arsyeve dhe argumenteve janë propozime të kryeshefit të cilat kanë rrjedhur si mos kryerje të punëve dhe detyrave që është i ngarkuar sekretari sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, Statutit të ndërmarrjes E... N...., po ashtu edhe rregulloren e brendshme për sistematizimin e vendeve të punës. Fillimisht si rrjedhojë e këtyre ka qenë pas emërimit tim si kryeshef ekzekutiv që është dashur ta dijë gjendjen reale në ndërmarrjes si juridike, financiare dhe operative. Fillimisht kamë kërkuar edhe nga sekretari të më informoj për çështjet juridike të ndërmarrjes për arsye të jem i informuar se ku kemi mbetur dhe ku duhet vazhduar, do të ndalem tek disa që janë cek në vendim si arsyetime. Ka qenë mosbashkëpunimi pothuajse mbi 6 muajt e fundit para se të merret vendimi për lirim, ku sekretari të gjitha raportet e mia periodike të vetat dhe të Z.... së po ashtu edhe raportin vjetor të ndërmarrjes nuk janë të kompletuara dhe të bashkangjitura në raportin e ndërmarrjes, pjesët financiare dhe ligjore si pjesë përbërëse e raportit ku ligji thotë se si pjesë e raportit të ndërmarrjes duhet të jenë edhe pjesa juridike dhe financiare gjë që nuk ka ndodhur asnjëherë, të gjitha kanë shkuar si raporte të ndara. Kam thirr sekretarin jam konsultuar dhe kemi kërkuar të sqarohemi, po përgjigjja e sekretarit ka qenë se i raportoj vetëm Bordit dhe jo ty, unë jam mundur ta sqarojmë bashkarisht që duhet të jetë pjesë përbërëse edhe pjesa juridike dhe financiare sepse në vijë horizontale më raportojnë edhe mua për punën ditore të ndërmarrjes dhe aktiviteteteve pavarësisht juridike apo financiare. Përgjigjja e sekretarit pothuajse në të gjitha rastete ka qenë se nuk je ti jurist nuk i din, nuk është ashtu dhe nëse vjen momenti unë të përgjigjem për këto dhe i sqaroj. Pastaj kemi kërkuar disa dokumente shtesë dhe përmes emailit si komunikim zyrtar që të m'i oforoj disa kontrata për punëtor në mënyrë që kur duhet t'i

vazhdojmë kontratat pasi që unë e kam gjetur në gjysëm procesin dhe kontratat kanë qenë 1 vjeçare që disa kanë qenë para skadimit. Përgjigjet e tij kanë qenë të lutëm e ke në arkiv dhe çka të duhet hajde shiqoj. Çështja tjetër ka qenë tek përdorimi i vulave të ndërmarrjes, fillimisht kur kam shku dhe skam mujt me arritë me i kompletu vendimet ku fillimisht e kam pyet sekretarin se a kemi vendim për përdorim të vulave sipas ligjit për vulat në Republikën e Kosovës dhe kush është i ngarkuar që t'i përdor ato, sekretari më është përgjegjur kështu, vendime nuk kemi dhe nuk është kompetencë e imja që të nxjerr vendime, por drejtoju Bordit së është kompetent, por kur kam shkuar unë sekretarin e kam gjetur duke e ushtruar atë detyrë ku i ka pasur vulat dhe i ka përdorur (vula rrumbullake dhe katrore e arkivit), dhe besoj që është dashur të jetë në njohuri për ekzistimin e atyre vendimeve dhe të paktën si sekretar a është dashur të ketë asi vendime. Pothuajse e njëjta ka ekzistuar edhe lidhur me planin e biznesit ku planin e biznesit ka përgjegjësi ligjore ta hartoj kryeshefi në bashkëpunim me zyrtarët e vet dhe atë dokument të cilin e harton një zyrtar, një zyrë duhet që patjetër ai ta argumentoj se është dokument i tij pavarësisht se a miratohet apo jo, ndërsa ajo nuk ka ndodhur, i kam të gjitha raporet dhe planet e biznesit që i'a kam dërguar sekretarit sipas kërkesës së tij. Pastaj ky ta fton takimin e Bordit dhe t'ua përcjell të gjitha materialet që janë në diskutim në rend të ditës, aty ka ndodhur që dokumentet e mia ka bërë ndryshime sekretari dhe në fund të dokumentit e ka vendosur emërtimin dhe vendin për nënshkrim të kryesuesit. Pastaj mendoj se ka tejkalim të kompetencave sepse për ftesën e këtyre takimeve të Bordit sipas Statutit dhe rregullores asnjëherë nuk jam pyetur unë si kryeshef për hartimin e rendit të ditës që me rregullore duhet të pajtohem unë dhe kryesuesi ndërsa sekretari ta fton seancën vetëm teknikisht. Sa i përket kontratës së sekretarit që e ka prezantuar në padi ka një mospërputhje të procedurave administrative dhe akteve administrative për emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes duke përfshirë edhe pozitën e kryeshefit është kompetencë e Bordit të Drejtorëve që ka një dallim në procedurë administrative nga punojësit e tjerë në ndërmarrje. Unë konsideroj që mungon një dokument që është Vendimi për emërim i dt. 04.08.2021 nr.prot 27/021 ku aty është e cekur paga dhe afati i kontratës, ndërsa kontrata është thirrur me një vendim të datës 02.08.2021 me nr. prot 22/021 ku ky vendim është vetëm se është shpallur si fitues, ndërsa kontrata ka ndryshim nga vendimi si akt administrativ ndërsa është përputh numri i njëjti i protokollit.

4. Ligji i aplikueshëm

Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 I Ligjit për Ndërmarrjet Publike, parashihet që *“Zyrtarët e NP emërohen nga Bordi i Drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre me ose pa deklarimin e arsyes.”* Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni parasheh që *“Secila NP do të ketë këta katër zyrtarë në vijim: (i) Kryeshefin Ekzekutiv, (ii) Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, (iii) Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarit e Korporativ dhe (iv) një Zyrtar për Auditim të Brendshëm.”*

5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, ka vërtetuar se shkarkimi i paditësit nga pozita e Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i NPL “E....K....” SH.A është bërë në përputhje me dispozitën e nenit 21 paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike e cila parasheh se Zyrtarët shërbejnë për Bordin dhe Bordi mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash ta ndërpresë kontratën e tyre dhe se Kryeshefi Ekzekutiv është njëri nga këta zyrtarë. Shkarkimi i paditësit nga pozita e Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i NPL “E....K....” SH.A është bërë edhe në përputhje me kontratën e punës me numër 22/021 e datës 02.08.2021, e cila në nenin 17 parasheh që *“të punësuarit i ndërpritet marrëdhënia e punës nga punëdhënësi nëse: 4) për shkak të mospërmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës”,* ndërsa neni 22 i kësaj kontrate parasheh

që *“Secila palë mund ta shkëpus këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme, sipas kushteve dhe rasteve të caktuara me Ligj dhe me Kontratën Kolektive”*.

Gjykata, vlerëson se Ligji për Ndërmarrjet Publike, është ligj special i cili përcakton mënyrën dhe kushtet për emërim të zyrtarëve kryesor, përfshirë këtu edhe Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarin, si dhe mënyrën e shkarkimit të këtyre zyrtarëve. Në këtë rast, gjykata vlerëson se Ligji i Punës nuk zbatohet me rastin e emërimit dhe shkarkimit të këtyre zyrtarëve e as ligjet e tjera nga marrëdhënia e punës sepse për këto pozita zbatohet ekskluzivisht Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe i përjashton të gjitha ligjet e tjera. Kësisojë, gjykata vlerëson se kontrata e punës së paditësit nuk ka paraparë kushte specifike për shkëputjen e kontratës së punës, mirëpo vetëm i është referuar ligji, e në këtë rast ligji është Ligji për Ndërmarrjet Publike. Në këtë rast, Ligji për Ndërmarrjet Publike nuk parasheh kushtin e paralajmërimit apo vërejtjes ndaj zyrtarit të cilit i ndërpritet kontrata e punës por një gjë e tillë mund të bëhet në çdo kohë dhe pa paralajmërim apo vërejtje paraprake, madje dispozita e nenit 21 paragrafi 1 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike, parasheh që kjo mund të bëhet edhe pa arsye, mirëpo e paditura në këtë rast ka dhënë arsyet e saj me rastin e marrjes së vendimit për lirim nga detyra dhe në këtë mënyrë ka vepruar drejtë sepse ndërprerja e kontratës së punës për zyrtarët e lartë të ndërmarrjeve publike pa dhënien e arsyes është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe me nenin 1 të Protokollit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili përfshin gjykimin e drejtë dhe barazinë e armëve të palëve pjesëmarrëse në procedure(cituar nga Aktgjykimi REV.nr.301/2018 i dates 23.10.2018 i Gjykatës Supreme të Kosovës).

Paditësi, pretendon se i njëjti ka përmbushur detyrat e punës sa ka qenë Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar dhe për këtë arsye shkarkimi i tij ka qenë i kundërligjshëm, mirëpo nga leximi i vendimit mbi shkarkimin e të njëjtit gjykata vëren se lirim nga detyra ka të bëjë me mos përmbushjen e detyrave të punës, andaj gjykata vlerëson se vlerësimin e këtyre çështjeve që lidhen me përmbushjen e detyrave nga ana e paditësit mund ta vlerësojë vetëm punëdhënësi pra në këtë rast NPL “E....K....” SH.A e jo gjykata, sepse nuk është në juridiksionin e gjykatës të merret me menaxhimin, operimin apo përformacën e ndërmarrjes sepse këto janë interes i përgjegjësve të ndërmarrjes dhe punëdhënësve në përgjithësi, ndërsa gjykata në këtë rast vlerëson se a janë respektuar të drejtat e punëtorëve me rastin e ndërprerjes së kontratës së punës dhe a është bërë shkëputja komfor dispozitave ligjore pozitive që e rregullojnë një gjë të tillë.

Gjykata vlerëson se lirim nga detyra i paditësit nga ana e Bordit të Drejtorëve të NPL “E....K....” SH.A, ka ardhur rreth 5 muaj pas miratimit të raportit të punës për vitin 2022, ndërsa për raportin për tremujorin e parë 2023 (Janar-Shkurt-Mars), nuk ka dëshmi se i njëjti është miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve. Andaj, gjykata vlerëson se lirim i paditësit nga pozita e Këshilltarit të Përgjithshëm/Sekretarit nuk ka të bëjë me kryerjen e detyrave të punës për vitin 2022 por ka të bëjë me periudhën 6 muaj para se të lirohet nga kjo detyrë, sepse një gjë e tillë vërtetohet edhe nga deklarimi i dëshmitarit Sh.... M.... i cili thekson se *“Ka qenë mosbashkëpunimi pothuajse mbi 6 muajt e fundit para se të merret vendimi për lirim,...”*. Gjykata vlerëson se është fakt se Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari nuk i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv por Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes, por sipas kontratës i njëjti ka pasur detyrim të përgatit raporte periodike sipas kërkesës së Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv, andaj në këtë pikë ai është dashur të bashkëpunojë edhe me Kryeshefin Ekzekutiv dhe gjykata vlerëson se lirim nga detyra e ka bërë pikërisht organi të cilit ai i përgjigjet, përkatësisht Bordi i Drejtorëve të NPL “E....K....” SH.A.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 463 paragrafi 1 i LPK-së, duke marrë parasysh se padisë e humbi kontestin ndërsa pala e paditur nuk i kërkojë shpenzimet e procedurës.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Dega në Skenderaj
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.297/2023, datë 12.04.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjes së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.